



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 802/13 Prot

Tiranë, më 17 / 7 / 2020

VENDIM

Nr. 22, datë 17 . 7 . 2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 802 Prot., datë 01.07.2020, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Elbasan” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit nëpërmjet kërkesës së datës 15.05.2020, depozituar në adresat elektronike aida.urupi@elbasani.gov.al dhe bashkiaelbasan@elbasani.gov.al, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni në lidhje me:

1. A ka bashkia një plan për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane? Nëse po, më vini në dispozicion një kopje?
2. A ka caktuar bashkia një venddepozitim për mbetjet urbane, apo për tipologji të tjera mbetjesh? Sa hektarë është kjo hapësirë? Sa kilometra larg qendrës së qytetit ndodhet ajo? A ka caktuar bashkia një venddepozitim për mbeturinat ndërtimore? A ekzistojnë të tjera venddepozitime mbetjesh, të pacaktuara nga bashkia?
3. Sa është përqindja (%) e territorit (në raport me totalin) që nuk mbulohet nga shërbimi i largimit të mbeturinave në bashkinë tuaj?
4. A ka bashkia juaj një marrëveshje apo kontratë me një kompani të caktuar (apo disa), e cila i grumbullon dhe i depoziton mbetjet urbane? Nëse po, cila është kjo

- kompani dhe sa kohë keni që bashkëpunoni me të? Më vini në dispozicion një kopje të kontratës së këtij bashkëpunimi.*
5. *A ka bashkia juaj një marrëveshje apo një kontratë bashkëpunimi me një kompani private, e cila i përpunon mbetjet tuaja urbane? Nëse po, cila është kjo kompani dhe sa kohë keni që bashkëpunoni me të? Më vini, në dispozicion një kopje të kontratës së këtij bashkëpunimi.*
 6. *A ka bashkia Struktura Kompostuese për Mbetjet e Ngurta Ricikluese?*
 7. *Sa është tarifa mujore për pastrim/gjembërimin që kanë paguar qytetarët tuaj në vitin 2018/2019 dhe sa do të paguajnë në 2020-ën (Ju lutem, ma specifikoni për qytetin dhe për fshatin, nëse janë të ndryshme)? Cili është raporti (%) i të ardhurave të grumbulluara nga tarifat e pastrimit dhe të higjenës me totalin e të ardhurave të shërbimeve të tjera publike për vitin 2019/2020? Sa prej shumës së grumbulluar nga kjo tarifë (në vlerë vjetore) ka shkuar për grumbullimin dhe depozitimin e mbetjeve dhe sa ka shkuar për pastrimin dhe gjembërimin e bashkisë për vitin 2019/2020? Sa është vlera e pagrumbulluar e tarifës së pastrim/gjembërimin (në raport me pjesën e grumbulluar) për vitin 2018 dhe 2019?*
 8. *Sa i ka kushtuar bashkisë vetëm grumbullimi i mbetjeve urbane për vitin 2018 dhe 2019? Sa parashikohet në 2020? Pra, sa keni shpenzuar për secilin prej këtyre viteve?*
 9. *A ka një kontratë bashkia juaj me Impiantin e Përpunimit të Mbetjeve në Elbasan (Inceneratori)?*
 10. *Sa para keni vendosur në dispozicion të grumbullimit/depozitimit, apo të përpunimit të mbetjeve urbane, prej fondeve të kushtëzuara ose/dhe prej fondeve të pakushtëzuara të marra prej qeverisë qendrore?*
 11. *Sa është sasia vjetore e mbetjeve urbane në bashkinë tuaj (në ton dhe konkretisht për vitin 2018/2019)?*
 12. *Si trajtohen mbetjet e rrezikshme në bashkinë tuaj? Cili subjekt (ose subjekte) merret me përpunimin e tyre? A ka një marrëveshje bashkëpunimi mes bashkisë tuaj dhe kësaj kompanie? Nëse po, më vini në dispozicion një kopje të kontratës me këtë kompani.*
 13. *A po zhvillohet në bashkinë tuaj, aktualisht, ndonjë projekt i financuar (ose në bashkëpunim) nga agjenci apo organizata të huaja financiare ose jofinanciare, që mbështet të ashtuquajturin “Menaxhim të Integruar të Mbetjeve Urbane”?*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 728 Prot., datë 17.06.2020 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ankuesi legjitimohet në kërkimin e tij.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave

Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 802/1 prot., datë 02.07.2020 ka kërkuar nga Autoriteti Publik vlerësimin e dhënies së informacionit, brenda datës 09.07.2020.

Me shkresën nr. 3126/1 prot., datë 09.07.2020, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 802/2 prot., datë 10.07.2020, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke i vënë në dispozicion ankuesit informacion lidhur me pikat e kërkesës objekt ankimi, por nuk ka bashkëlidhur kontratat e kërkuara në pikën 4 dhe 5, për të cilat është shprehur se *mund të gjenden në portalin e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe atë të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit*.

Ankuesi, duke e konsideruar të paplotë përgjigjen e dhënë nga Autoriteti Publik, me emailin e datës 09.07.2020, ka vijuar ankimin duke kërkuar dokumentacionin e cituar vetëm në pikat 4 dhe 5 të kërkesës për informacion.

Në këto rrethana, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, në parim informacioni/dokumentacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”*.

Nisur nga fakti që ankuesi ka vijuar ankimin për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në pikën 4 dhe 5, si rrjedhojë informacioni i kërkuar për pikat 1, 2, 3, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 konsiderohet i përmbushur.

Bazuar në nenin 1 të ligjit të sipërcituar, përcaktohet qartë se, *objekt i këtij ligji është çdo informacion që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike*. Në këtë kuptim, çdo autoritet pavarësisht nëse është në cilësinë e *“prodhuesit”* apo *“mbajtësit”* të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

Gjithashtu, sqarojmë se, bazuar në pikën 2 të nenit 12 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, Autoriteti Publik vetëm në rastet kur konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ka detyrimin ta dërgojë atë pranë autoritetit kompetent duke vënë në dijeni edhe kërkuuesin.

Ligji nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike.

Detyrimi për bërjen transparente të veprimtarisë së tyre, njësisive të qeverisjes vendore i'u lind gjithashtu edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

Konkretisht në nenin 15 të ligjit të sipërcituar "Transparenca e veprimtarisë së njësisive të vetëqeverisjes vendore", parashikohet se: *"1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre. 2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike..."*.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar.

Gjithashtu, Autoriteti Publik në bërjen publike të dokumentit të kërkuar, duhet të mbajë në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku përcaktohet se: *"Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim"*.

Në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar parashikohet se: *"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit"*.

Bazuar në nenin 15 të po këtij ligji, *"autoriteti publik trajton kërkesën për informim brenda 10 ditëve pune nga data e dorëzimit të saj"*. Ndërkohë në pikën 1, të nenit 18 parashikohet se *mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji, passjell përgjegjësi administrative*. Në pikën 2, të nenit 18 parashikohet se *veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë vepër penale konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë personat përgjegjës*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkzionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e z. Artan Rama ndaj Autoritetit Publik/Bashkia Elbasan, Komisioneri vlerëson se, duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër, ankimi është bazuar në ligj dhe si i tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012

“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin pjesërisht të ankesës nr. 802 Prot., datë 01.07.2020 të z. _____, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Elbasan”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në pikën 4 të kërkesës për informacion të datës 15.05.2020 (A ka bashkia juaj një marrëveshje apo kontratë me një kompani të caktuar (apo disa), e cila i grumbullon dhe i depoziton mbetjet urbane? Nëse po, cila është kjo kompani dhe sa kohë keni që bashkëpunoni me të? Më vini në dispozicion një kopje të kontratës së këtij bashkëpunimi) dhe pikën 5 të kërkesës (A ka bashkia juaj një marrëveshje apo një kontratë bashkëpunimi me një kompani private, e cila i përpunon mbetjet tuaja urbane? Nëse po, cila është kjo kompani dhe sa kohë keni që bashkëpunoni me të? Më vini, në dispozicion një kopje të kontratës së këtij bashkëpunimi), brenda datës 24.7.2020.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 17.7.2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

